

REPUBLIKA E SHQIPERISE
ZYRA E NOTERISE
TIRANE

Nr. 706 Rep
Nr. 181 Kol



KONTRATE DHURIMI KUOTASH DHE KAPITALESH

Sot me date 29.02.2000 (dymije), ne Zyren e Noterise, u paraqiten personalisht para meje

Ne cilesine e **dhuruesit**
Etleva Hajdari, e bija e Hasanit e datelindjes 1973, lindur ne Diber dhe banues ne Bulqize madhor dhe me zotesi te plote juridike e per te vepruar me pasaporten Nr 1326575.

Ne cilesine e **pranuesit te dhurimit**
Lefter Alla, i biri i Sadikut i datelindjes 1972, lindur dhe banues ne Bulqize, madhor dhe me zotesi te plote juridike e per te vepruar, i identifikuar me certifikaten me fotografi Nr 34/62 Bulqize.
te cilet kerkuan redaktimin e kesaj kontrate :

Me vendimin e Gjykates se Rrethit Tirane Nr. 21356 date 19.05.1999 eshte regjistruar si person juridik, Shoqeria me pergjegjesi te kufizuar "ALB LEAA INTERNATIONAL" sh.p.k., me ortak te vetme Zj. Etleva Hajdari. Duke u mbeshtetur veprimtarine e shoqerise ne Statutin dhe Kontraten e Themelimit une ortakja e vetme zoteroj ne emer te shoqerise 100% (njqind perqind) te kapitalit fillestar dhe te kuotave.

Ne baze te Vendimit Nr.1 te Ortakes se vetme te kesaj shoqerie, date 28.02.2000, une Etleva Hajdari ia dhuroj 50% te kapitalit fillestar dhe kuotat e kesaj shoqerie z.Lefter Alla pa asnje kusht e shperblim dhe me vullnetin tim te lire e te plote.

Z.Lefter Alla e pranon me kenaqesi dhurimin si me siper per 50 % te kapitalit te shoqerise se mesiperme.

Se bashku me pranimin e kuotave te kapitalit te shoqerise te dhuruar, (50 %) Z.Lefter Alla pranon edhe te gjitha detyrimet ligjore qe ka shoqeria ne lidhje me te tretet dhe me organet shteterore.

Me nenshkrimin e kesaj kontrate dhurimi, dhuruesja Etleva Hajdari humbet çdo te drejte pronesie mbi 50% te kapitalit i cili i kalon teresisht z.Lefter Alla.

Pronar i vetem i 50% te kapitalit behet pranuesi i dhurimit z.Lefter Alla, duke u shenderuar shoqeria nga shoqeri me nje ortak ne shoqeri me dy prtake.

Kjo kontrate u perpilua ne kater kopje me fuqi te barabarte ligjore dhe duke qene e bazuar ne ligj vertetohet prej meje noteris

DHURUESI

PRANUESI I DHURIMIT

LEFTER ALLA

Etleva Hajdari
EHP

NOTERE

